



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**LEGJISLATURA IV**

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**  
**Mbledhja nr. 48.**  
**Prishtinë, më 27.08.2012 në ora 10:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, ,  
Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj.

**Munguan:** Elmi Reçica, Glauk Konjufca dhe Mufera Sinik

**Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë:** përfaqësuesja nga OSB, Lejla Selimi, përfaqësues nga zyra e KDI-së Nevahir Hazeri, përfaqësues nga zyra – EU Pleurat Kurti, përfaqësues nga zyra e OSB-së Jeton Bytyqi, Bekim Kodraliu, përfaqësuesi nga zyra e Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

**Emrat e stafit mbështetës të komisionit,** Kordinatore - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore,  
Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-126 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-099 për Letërnjoftimin, me raportin e komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, dhe amendamentet e propozuara të Grupit Parlamentar 6 +.**

**Kryesuesi** – konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, njëherit hapi mbledhjen me këtë pikë të rendit të ditës

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesi** – konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-126 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-099 për Letërnjoftimin, me raportin e komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, dhe amendamentet e propozuara të Grupit Parlamentar 6 +.**

**Kryesuesi**, në fjalinë e tij tha se në mbledhjen e kaluar nuk është proceduar raportin i Komisionit FunkSIONAL, me shqyrtim të amendamenteve të GP 6 + në Projektligjin nr. 04/L-126 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-099 për Letërnjoftimin, me apo pa përkrahje.

Në këtë takim, Komisioni zyrtarisht është marr Raporti final me shqyrtimin e amendamenteve të GP 6 +, dhe se të njëjtat nuk janë përkrahur nga komisionit FunkSIONAL.

Ai kërkoi që komisioni të deklarohet për votim të raportit me amendamente të komisionit funksional dhe njëherit hapi debat nëse ka ndonjë propozim tjetër.

**Albert Kinolli** – me theks të veçantë tha se në emër të GP 6 + me datën 5 korrik 2012, i ka proceduar amendamente në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ai mendon se të njëjtat nuk janë përkrahur nga komisioni funksional.

Sa i përket shqyrtimit të amendamenteve të GP 6+, ai pajtohet me vendimin të cilin do e merr komisioni për komunitete dhe kthim.

**Xhevdet Neziraj** – theksoi se komuniteti turk ka dhënë propozim amendamentin e GP 6+ dhe se me këtë propozim ngarkohet Ligji për përdorimin e gjuhëve. Në këtë drejtim, lidhur me realizimin e procedimit të amendamentit të GP 6+, komisionit FunkSIONAL nuk ka dhënë përgjigje me shkrim. Ishte i mendimit se në komisionin funksional është një anëtarë i komisionit tanë dhe se gjatë shqyrtimit të të njëjtave amendamente është dashtë të reagohej me kohe.

**Kryesuesi**, tha se para këtij takimi ka kontaktuar me kryetarin e komisionit funksional z Jusufi dhe i cili ka konstatuar se amendamenti i GP 6+, i propozuar të fshihet neni 4 i ligjit për letërnjoftim, dhe se bie në ndeshje me nenin 4, të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Në kuadër të procedurave Parlamentare ai propozoi që Komisioni të deklarohet për votim të amendamenteve të Komisionit funksional.

***Kryesuesi** – konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, mur qëndrim për miratimin e Raportit me amendamente të komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin Nr. 04/L-126 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-099 për Letërnjoftimin, dhe nxori këtë:*

#### ***Përfundim***

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr. 04/L-126 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-099 për Letërnjoftimin dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

#### **2. Të ndryshme.**

**Kryesuesi**, në pikën në të ndryshme ai ngriti dy çështje: së pari e informoi komisionin se zyra e Komisionit të Larët për Pakicat Kombëtare nga Holanda, ka organizuar një tryezë të rumbullakët, me temën ballafaqimi me të kaluarën në Kosovë.

Do të diskutohet për dialogun konstruktiv ndërmjet grupeve të ndryshme dhe forcave politike, duke përfshirë Komisionin Parlamentar për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, si dhe grupe të ndryshme të shoqërisë civile dhe përfaqësues të komuniteteve jo shumicë.

Ai propozoi që në përbërja të plotë, komisioni të marr pjesë në këtë konferencë e cila do të mbahet me 11.09.2012, në hotelin Swiss Daimond, në Prishtinë.

Më pas e informoi komisionin se me kërkesë të Ambasadës Norvegjeze, do të mbahet takimi me delegacionin nga Parlamenti i Norvegjisë në Asamblenë Parlamentare të Keshillit të Evropës, me datën 7.09.2012. Në veçanti, do të diskutohet tema : situata lidhur me të drejtat e njeriut dhe problemet e komuniteteve pakicë në Kosovë.

Në këtë takim do të marrin pjesë përfaqësuesit e komuniteteve nga komisioni janë .

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

**Përgatitur nga:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetar i Komisionit**

---

**Goran Marinkovic**